



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. _____ Prot.

Datë .02.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Karburant”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Karburante (09100000-0)**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 39,758,303 (tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e
pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e tre) lekë PA TVSH e ndarë në dy Lote:**

**Loti 1: Naftë : 36,135,602 (tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e
gjashtëqind e dy) lekë PA TVSH.**

**Loti 2: Benzinë : 3,622,701 (tre milion e gjashtëqind e njëzetë e dy mijë e shtatëqind e
një) lekë PA TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçe** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti 1 Naftë

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, 2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **vlera e fondit limit e Lotit që prokurohet**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogel se vlera e fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne:*nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në zbatim të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, I ndryshuar, VKM-së Nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

2.3 Për kapacitetin teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **40 %** të vlerës të perlllogaritur të Lotit që prokurohet / **shumatores së loteve në të cilat merr pjesë.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Gjithashtu vlera e kërkuar bazohet në nenin 42 pika 3 të vkm 285 ku përcaktohet se “ Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

a – Ofertuesi duhet të jete i licencuar për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij.

Per sa me sipër duhet të paraqesë : Autorizim për ushtrim aktiviteti “Tregeti me pakice të lendeve djegëse Karburante” ose Licence për tregtimin me pakice të karburanteve, gazit të lengshëm naftes për automjet, vajrave lubrifikant për përdorim nga konsumatorët fundorë” të lëshuar nga Bashkia Korçë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a, VKM -se nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe V.K.M nr. 970- datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

b- Leje për ushtrim aktiviteti 24 ore për të paktën një stacion shitjeje me pakice të lendeve djegëse karburante brenda Bashkisë Korçë shoqëruar me Autorizimin për hyrje

dalje ne rruge per kete stacion shitje.Leja per ushtrim aktiviteti 24 ore duhet te jete leshuar nga Bashkia Korçë .Autorizimi per hyrje dalje ne rruge duhet te jete leshuar nga Bashkia Korçë, ndersa ne rastet kur stacioni ndodhet ne rruge nacionale autorizimi per hyrje dalje duhet te jete i leshuar nga Enti Regullator i Rrugeve .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,VKM -se nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteri i mesiperm u vendos duke patur parasysh percaktimin e bere ne specifikimet teknike qe “Furnizimi i mjeteve te transportit do te behet sipas sipas kerkesave te institucionit, ne cdo ore te dites a te nates,gjate gjithe javes”,per kete arsye eshte e nevojshme leja per ushtrim aktiviteti 24 ore.

Autorizimi per hyrje dalje eshte i nevojshem per arsye se eshte nje dokument qe eshte i domosdoshem per ushtrimin e aktivitetit te shitjes te karburantit .”

c- Raport analize te cilesise se karburantit (nafte)te leshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknike dhe Industrial (ISHTI). Raport analiza duhet te jete leshuar brenda 6 muajve nga data e hapjes se tenderit.

Argumentimi: Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e *Raport analizave* është përcaktuar proporcionalisht dhe ne perputhje me objektin e kontrates, bazuar në nenin 77, te LPP, si dhe nenin 40, par. 6, pika c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe eshte vendosur me qellim qe Autoriteti Kontraktor te vleresoje perputhshmerine e mallrave me standartet teknike si dhe per te garantuar cilesine dhe origjinalitetin e mallrave.

2.4 Te tjera:

Ofertuesi duhet te paraqese deklarate se ofron sherbimin nepermjet kartes elektronike ne perputhje me VKM Nr 561 date 29.07.2016.

Argumentimi : *Ky kriter është vendosur bazuar ne VKM Nr.561, datë 29.7.2016 ”Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe ka të bëjë me mënyrën e përdorimit të karburantit të parashikuar për cdo mjet që do të furnizohet.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIME

- **Specifikime Të dhënat teknike të Gazoil duhet ti referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar SSH EN 590 : 2013 + A1:2017**
- **Operatorët ekonomike janë të detyruar të paraqesin ne ofertat e tyre mallrat e kerkuara sipas standartit të kerkuar si me sipër:**
- **Kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave**

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara	
		minimale	maksimale
Numri i cetanit		51,0	-
Indeksi i cetanit		46,0	-
Densiteti në 15 °C °	kg/m ³	820,0	845,0
Hidrokarburët aromatikë policiklikë	% (m/m)	-	8,0
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0
Pika e flakërimit	°C	55	-
Mbetja e karbonit (në 10 % mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0,30
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010
Pika e bllokimit të filtrit në te ftohte CFPP	°C	-	-
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vleresimi	Klasa 1	
Përmbajtja e esterit të metilit të acidit yndyror (FAME)	% (V/V)		7,0
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50
Përmbajtja e ujit	%m/m	-	0.020
Lubricitetit, diametri i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer) (ësd 1,4) në 60°C	µm	-	460
Pika e turbullimit	°C	-	-
Ndotja e përgjithshme	mg/kg	-	24
Qëndrueshmëria ndaj oksidimit	g/m ³	-	25
Distilimi :			
distilati që vlon në 250°C,% (v/v)	% (V/V)	85	65
distilati që vlon në 350 °C,%(v/v)	% (V/V)		
distilati që vlon në 95 % (v/v)	°C		360

Loti 2 Benzine

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit e Lotit që prokurohet / shumatores së loteve në të cilat merr pjesë”.

Kjo do të vërtetohet duke paraqitur vërtetim për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit leshuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne:nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,në zbatim të Ligjit nr.8438,datë 28.12.1998“Për tatimin mbi të ardhurat”,I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5,datë 30.01.2006,“Për tatimin mbi të ardhurat”,I ndryshuar,VKM-së Nr.922 datë 29.12.2014“Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore,vetëm nëpërmjet formes elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Për kapacitetin teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo

më të vogël se **40 %** të vlerës të perlloritur të *Lotit që prokurohet / shumatores së loteve në të cilat merr pjesë.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

a – Ofertuesi duhet të jete i licencuar për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij.

Per sa me sipër duhet të paraqese : Autorizim për ushtrim aktiviteti “Tregeti me pakice të lendeve djegese Karburante” *ose* Licence për tregtimin me pakice të karburanteve, gazit të lengshem naftes për automjet, vajrave lubrifikant për përdorim nga konsumatorët fundorë” të lëshuar nga Bashkia Korçë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a, VKM -se nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe ligjit nr.8450, datë 24.2.1999

”Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes,të gazit dhe nenprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe V.K.M Nr. 970- datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

b-Leje per ushtrim aktiviteti 24 ore per te pakten nje stacion shitjeje me pakice te lendes djegese karburante brenda Bashkise Korçë.

c) Autorizimi per hyrje dalje ne rruge duhet te jete leshuar nga Bashkia Korçë, ndersa ne rastet kur stacioni ndodhet ne rruge nacionale autorizimi per hyrje dalje duhet te jete i leshuar nga Enti Regullator i Rrugeve .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,VKM -se nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 ”Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes,të gazit dhe nenprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe V.K.M Nr. 970- datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

d- Raport analize te cilesise se karburantit (BENZINE)te leshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknike dhe Industrial (ISHTI). Raport analiza duhet te jete leshuar brenda 6 muajve nga data e hapjes se tenderit.

Argumentimi: Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e *Raport analizave* është përcaktuar proporcionalisht dhe ne perputhje me objektin e kontrates, bazuar në nenin 77, te LPP, si dhe nenin 40, par. 6, pika c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe eshte vendosur me qellim qe Autoriteti Kontraktor te vleresoje perputhshmerine e mallrave me standartet teknike si dhe per te garantuar cilesine dhe origjinalitetin e mallrave.

2.4 Te tjera:

Ofertuesi duhet te paraqese deklarate se ofron sherbimin nepermjet kartes elektronike ne perputhje me VKM Nr 561 date 29.07.2016.

Argumentimi : Ky kriter është vendosur bazuar ne VKM Nr.561, datë 29.7.2016 ”Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe ka të bëjë me mënyrën e përdorimit të karburantit të parashikuar për cdo mjet që do të furnizohet.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIME

- Të dhënat teknike të Benzines duhet ti referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar SSH EN 228:2012 + A1:2017.
- Operatorët ekonomike janë të detyruar të paraqesin ne ofertat e tyre mallrat e kerkuara sipas standartit të kerkuar si me siper:
- Kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Treguesi Cilësor	Njësia `e matjes	Norma e lejuar	
		Minimale	Maksimale
Numri i oktanit kërkimor, RON		95,0	-
Numri i oktanit motorik, MON		85,0	-
Densiteti (në 15 °C)	kg/m ³	720,0	775,0
Përmbajtja e sqfurit	mg/kg	-	10,0
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë / 50°C)	Renditje	klasa 1	
Pamja e jashtme		E pastër dhe e tejdukshme	
Distilimi			
a. Distilon deri 70°C	% (V/V)	20	48
b. Distilon deri 100°C	% (V/V)	46,0	71,0
c. Distilon deri 150°C	% (V/V)	75	-
d. Pika finale e distilimit	°C	-	210
e. Mbetjet e distilimit	% (V/V)	-	2
Përmbajtja e tipit të hidrokarburit			
a. Olefinat	% (V/V)	-	18
b. Aromatiket	% (V/V)	-	35
Permbajtja e benzenit	% (V/V)	-	1
Përmbajtja e oksigjenit	% (m/m)	-	3.7
Përmbajtja e komponimeve oksigjenore			

a	Methanol (alkool metilik)	% v/v	-	3
b	Etanol (alkool etilik)	% v/v	-	5
c	-Alkool izoprofilik - Alkool izo butilik -Alkool terc butil -Etere (me 5 ose me shume atome C) -Komponime oksigjenore te tjera			Perzierja ne vellim i kufizuar ne 2.7% (m/m) te permbajtjes maksimale te oksigjenit.

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi :**Kjo kontrate ka per qellim realizimin e furnizimit me karburant.**

Kontraktuesi duhet te furnizojë me karburant ne perputhje me standartet e kerkuara dhe specifikimet teknike.

Afati: 12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader.

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Karburanti eshte kerkuar sipas sasive dhe nevojane efektive per te permbushur nevojat e ndermarrjes ne menyre te plote per realizimin e sherbimeve ne interes te komunitetit.

Specialisti i larte i mjeteve te transportit ne sektorin mekanik

Erjus Shahollari

Pergjegjesi i ofcines

Ilia Zhuli

Brigadieri

Ferdiand Pelteku

NJËSIA E PROKURIMIT

PËLLUMBESHA NURÇE (KRYETARE)

ANIKA PRIFTI (ANËTARE)

KLEMENTINA MUSAKA (ANËTARE)